


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr.208 Regj Them
Dt.30.07.2018

Nr. Vendimi
Dt.21.01.2019

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga,

GJYQTAR

GERD HOXHA

asistuar prej sekretares gjyqsore **Znj.Silvi Xhakollı** sot më datë **21 janar 2019**, me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqëuar nga prokurori **Z.Agron Gjana**, mori në shqyrtim në seancë gjyqsore publike, kërkësën penale me nr.208akti, me :

Viktima akuzuese :

Taulant Balla, i biri i Kasëm dhe i Fatime, i dtl.12.08.1977, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë Rr.“Reshit Petrela”, shqiptar, i martuar, arsimi i lartë, i padënuar, përfaqësuar në gjykim nga *Av.Gentjan Rumano*.

I akuzuar :

Lulzim Basha, i biri i Xhelal dhe i Remzije, i dtl.12.06.1974, lindur dhe banues në Tiranë, Rr.“Demir Gashi”, Nr.3, shqiptar, i martuar, i padënuar, përfaqësuar në gjykim nga *Av.Ivi Kaso* dhe *Av.Gazmend Bardhi*.

Palë e interesuar :

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë përfaqësuar në gjykim nga prokurori **Z.Agron Gjana**.

Akuzuar :

Për veprën penale të “*Shpifjes*” parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqso, pasi administroi provat shkresore; dëgjoi të viktimën akuzuese Z.Taulant Balla që kërkoi deklarimin fajtor dhe dënimin e të akuzuarit Z.Lulzim Basha për kryerjen e veprës penale të “*Shpifjes*” së kryer botërisht, parashikuar nga neni 120/2 i KP;

dëgjoi mbrojtësit e të akuzuarit Z.Lulzim Basha që kërkuan pafajësi ose pushimin e gjykimit;

dëgjoi prokurorin që, kërkoi pushimin e çështjes;
si dhe pasi shqyrtoi në tërësi çështjen

VËREN

Se, nga viktima akuzuese Z.Taulant Balla është sjellë për gjykim kërkesa penale kundër të akuzuarit Z.Lulzim Basha, akuzuar për veprën penale të “*Shipifjes*”, së kryer botërisht, parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se, viktima akuzuese Z.Taulant Balla është deputet i Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë. I akuzuari Z.Lulzim Basha është kryetar i Partisë Demokratike, njëkohësisht edhe deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

Në fjalimin e tij në Kuvend të datës **21 qershor 2018**, i akuzuari Lulzim Basha ka diskutuar rrëth çështjes së hapjes së negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Nga foltorja e Kuvendit, ai diskutoi për shqetësimin e Gjermanisë, skeptike sipas tij, për t'i dhënë “ok” hapjes së negociatave me Shqipërinë. Gjithashtu, Z.Basha është shprehur se opozita ka ndikuar pozitivisht në lidhje me këto negociata, fjali kjo që ka shkaktuar të qeshura në parlament.

Në këtë moment i akuzuari Z.Lulzim Basha i është drejtuar deputetit Z.Taulant Balla me fjalët “*Njëri prej atyre që zgërdhihet më shumë ka qënë në Gjermani para 3 ditësh, ka porositur një “Toyota Yaris”. Po ta kanë zbuluar Toyotën o zgërdhimtar bashkë me 1.5 milion euro të drogës brenda, vazhdo qesh se do të shikosh se çfarë do të tē tundet përpara hundës shumë shpejt...*”

Viktima akuzuese Z.Taulant Balla pretendon se, nëpërmjet këtij fjalimi Z.Lulzim Basha ka shpifur kundrejt victimës akuzuese Z.Taulant Balla.

Ky fjalim i tij, përveçse është transmetuar *drejtëpërdrejtë* nga seanca e Kuvendit, është transmetuar gjithashtu disa herë nga mediat. Gjithashtu, është bërë lajm nga mediat e shkruara dhe ka patur një përhapje të gjërë.

Ka rezultuar i vërtetë fakti se më datë **24 qershor 2018**, në Portin e Durrësit në orën 07:30, mbërriti nga Belgjika një trajler tip “*Bizark*” me 9 automjete, përmes Portit të Barit, Itali. Policia Kufitare ka bërë identifikimin dhe ndalimin e 2 mjeteve tip “*Toyota*”, në të cilat janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zviceriane, të padeklaruara.

Lidhur me këtë fakt Policia e Shtetit më pas në një deklaratë për shtyp ka informuar se: “*Policia e Shtetit është vënë në dijeni nga burimet e saj vëndase, në datë 20 Qershor 2018, ditën e mërkurë, për një karoatrec që pritej të transportonte disa autovetura, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruara, pa specifikuar tipin e automjeteve dhe as origjinën e vendit. Me marrjen e këtij informacioni, i'u është dhënë porosi gjithë strukturave në Pikat e Kalimit Kufitar për konstatimin dhe kontrollin e kësaj ngarkese*”.

Ditën e enjte, 21 Qershor 2018, në mesditë, gjatë punimeve në sallën e Kuvendit, është bërë publik fakti lidhur me një automjet tip “*Toyota Yaris*” me 1.5 milion euro, të zbuluar në Gjermani. Po atë ditë, të enjten e kaluar, datë 21 Qershor 2018, një agjenci ligjzbatush shqiptare në orën 17:00, ka njoftuar Policinë e Shtetit lidhur me një informacion për një ngarkesë me trajler që do

të sillte disa mjete tip "Toyota", e cila pritej të vinte nga Gjermania, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruara. Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasit:

- A.C., 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës;
- E.L., 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë;
- K.L., 21 vjeç, lindur në Bulqiz, banues në Tiranë;
- A.M., 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë.

Gjithashtu, sipasdeklaratës së Policisë rezulton se, janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasve:

- A. V., 33 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë;
- E. V., 38 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë.

Viktima akuzuese Z.Taulant Balla pretendon se, **nëpërmjet fjalimit të tij i akuzuari Z. Lulzim Basha ka ngritur një akuzë të drejtpërdrejtë**, se ishte Z.Taulant Balla porositësi i makinës tip "Toyota Yaris", në të cilën gjendeshin paratë e drogës **në sasinë prej 1,5 milion euro**. Viktima akuzuese pretendon se, kjo deklaratë e Z.Lulzim Basha ka rezultuar të jetë pjesërisht e vërtetë, pasi është ndaluar një makinë e tillë, por është totalisht i pavërtetë fakti se kjo makinë ka ardhur me porosi të Z.Taulant Balla. Ka rezultuar i vërtetë fakti se kanë ardhur në port dhe kanë ndaluar dy mjete tip "Toyota", por nuk lidhen aspak me deputetin Z.Taulant Balla. **Nuk ka asnje provë apo dëshmi nga të gjithë dëshmuarit, që të lidhë deputetin Z.Taulant Balla me makinat e ndaluara, si edhe sasinë e parave të gjendura në të.**

Për pasojë, viktima akuzuese Z.Taulant Basha pretendon se, kjo akuzë e të akuzuarit Z. Lulzim Basha cënon reputacionin, nderin dhe dinjitetin e viktimës akuzuese. Kjo deklaratë **nuk është një gjykim vlerësues (opinion), që me të drejtë mund të jap i akuzuari për shkak të postit te tij, por një akuzë konkrete për një fakt konkret**, e cila nuk mund te justifikohet se është për shkak të postit të të akuzuarit, për shkak të burimeve të besueshme, apo edhe faktit të pretenduar në seancë, se i akuzuari nuk ka patur asnjë arsyё përsë mos ta besonte burimin e tij, që e ka informuar mbi të dhënat e përdorura gjatë fjalimit të tij, në seancën e Kuvendit më dt.21.06.2018.

Në deklarimin e tij, i akuzuari Z.Lulzim Basha përdor në drejtim të viktimës akuzuese Z.Taulant Balla shprehje të tillë si "**ke pororsitur një makinë tip "Toyota Yaris", po ta kanë zbuluar "Toyotën" o zgërdhimtar bashkë me 1,5 milion euro të drogës brënda**".

Viktima akuzuese Z.Taulant Balla pretendon se, i akuzuari Z.Lulzim Basha nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përgënjeshtrimin e deklaratave të tij. Përkundrazi, ai vazhdoi dhe vazhdon të sulmojë imazhin e Z.Taulant Balla në të gjitha deklarimet e tij në faqen zyrtare në rrjetin social "facebook" të Partisë Demokratike dhe në intervistat e tij.

Konkreksht, në deklaratën për shtyp të datës **25 qershor 2018** transmetuar kjo edhe në mediat vizive i akuzuari Z.Lulzim Basha është shprehur: "**Taulant Balla është garant i miliona eurove para të drogës të kapura në "Toyota Yaris", që i përkasin një prej bandave më të rrezikshme të trafikut të drogës. Policia shqiptare veproi nën presionin e një prej vëndeve partnere, që është skeptik përsa i përket kushteve të Shqipërisë për integrimin europian.**

I vetmi dekonspirim është ai i planit të Taulant Ballës dhe i strukturave brenda Policisë

së Shtetit dhe Parlamentit shqiptar për të çuar deri në fund bashkëpunimin me një nga bandat kryesore të drogës së Elbasanit dhe për të futur miliona euro të drogës në Shqipëri.

Edi Ramën, Sajmir Tahirin, Fatmir Xhafën, Taulant Ballën, Erjon Veliajn i lidh trafiku i drogës, pastrimi i parave, ndërtimi i kullave, siç janë ato të Teatrit Kombëtar. Ndërtimi narkoshtetit nga Edi Rama është arsyaja pse këtë javë Bashkimi Europian, vendos që Shqipëria s'i ka plotësuar kushtet për hapjen e negociatave".

Në vijim, viktima akuzuese Z.Taulant Balla paraqiti si provë komunikimin me gazetarët të të akuzuarit Z.Lulzim Basha :

'Pyetje: Pas ngjarjes së djeshme janë kuriozë të gjithë të dinë sesi e mësuat për për Toyota-n me një shumë, shumë më të madhe sesa e thatë ju në Parlament?

Basha: Mund t'ju them vetëm tre gjëra. E para, që paratë janë të një prej bandave më të rrezikshme të trafikut të drogës, aktive kryesishët në zonën e Elbasanit, por edhe të gjithë Shqipërisë. E dyta, Taulant Balla kishte marrëveshje për të garantuar hyrjen e këtyre parave pa problem në Shqipëri. E treta, policia shqiptare ka qenë nën presionin e një prej partnerëve tanë për të vepruar. Është nnjë nga vendet partnere, i cili është skeptik persa i përket kushteve të Shqipërisë, për integrimin në veçanti krimit dhe korruptionit.

Pyetje: Gjermania apo Belgjika?

Basha: Kaq mund t'ju them. Tre gjëra thashë që do t'ju them dhe j;ua thashë. Të rrimë pak tek droga dhe krimi. E di që nuk është temë favorite as e Partisë Socialiste, as e ndërtuesve e as e disa mediave.

Pyetje: Është dekonspiruar?

Basha: Po, sigurisht, është dekonspiruar plani i Taulant Ballës dhe i strukturave brenda Policisë së Shtetit dhe Parlamentit shqiptar, për të çuar deri në fund këtë bashkëpunim me një nga bandat kryesore të drogës së Elbasanit dhe për të futur miliona euro të drogës në Shqipëri. Kjo është dekonspiruar pa pikë dyshimi. S'besoj se ju vjen keq, sigurisht që Jo. Çështja është fare e thjeshtë. Kemi një Ministër të Brendshëm, kokën e trafikut të drogës, që del e shëtit me kalë, sepse e ka liruar Edi Rama, kryeprokurori, kryegjytari aktual. Kemi Ministrin tjetër të Brendshëm, që përpinqet nga mëngjesi deri ne darkë të justifikojë vëllain e tij trafikant droge. Tani, kemi kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Sekretarin e Partisë Socialisie, i cili merret me pastrimin e parave të drogës. Kanë kaluar tek kokaina dhe heroina. Tani kanë kaluar tek pastrimi i parave te pista. Ja çfarë ndodh. 1 milionë e 500 mijë euro ka qenë pakti. Të shikojmë sesa është komunikata zyrtare e policisë dhe marrëveshja është garantuar nga Taulant Balla. Ky ka hyrë garant. Këtë mund t'ju them unë sot, sepse jam i sigurtë që këtë pastaj tregojnë faktet dhe koha, siç i ka vërtetuar deri më sot, të gjitha siç iu kam thënë".

Pyetje: Taulant Balla ju tha atë ditë që nuk ...

Basha: Taulant Ballën mund ta pyesni vetë. Nuk jam këtu për të komentuar deklaratat e një personi që sot duhet të ishte para drejtësisë për shumë çështje dhe jo vetëm për këtë. Por çështja më e thjeshtë është kjo. Ku do të shkojnë këto para? Së gjërat lidhen. Çfarë e lidh Sajmir Tahirin, Fatmir Xhafën, Taulant Ballën, Erjon Veliajn, çfarë i lidh këta të katërt, përvèç Edi Ramës, bosit të bosëve, çfarë i lidh trafiku i drogës, pastrimi i parave, ndërtimi i kullave, e gjithë kjo që bëhet, edhe zallamahia që bëhet për të rrëmbyer tokën e teatrit, për të ndërtuar kullat, ato kulla do të ndërtohen për të pastruar këto para të krimitSot merrem me anën politike dhe ana politike është kjo; kanë

kaluar nga kanabisi i Sajmir Tahirii, tek kokaina e heroina e Xhafajt me shokë, tanë tek pastrimi i parave të pista të drogës nga Sekretari i Përgjithëshëm i Partisë Socialiste dhe kryetari i Grupit Parlamentar Socialist. Ku do të shkojnë këto para? Këtë pyetje duhet të bëni sot. Ku do të shkojnë këto para, përveçse tek kullat e Erjon Velisë? Ku tjetër do të shkojnë këto para të drogës? Sa biznese do të shkatërrojnë, sa vende pune do të mbyllin? Sa viktima do të shkaktojnë? Sa shqiptarë do të largojnë nga vendi? Për sa kohe do t'ia mbani të mbyllura dyert e Europës? Këto janë pyetje që duhet të na mundojnë dhe për të cilat duhet të gjemë zgjidhje dhe përgjigje. Faleminderit!"

Viktima akuzuese Z.Taulant Balla pretendon se, deklarimi i përmendur më lart, përbën një pretendim fakti, i cili në vetvete në mënyrën si është formuluar, përbën një akuzë tejet serioze, konkretisht **se viktima akuzuese Taulant Balla bashkëpunon me banda të rrezikshme kriminale, garanton për ta, porosit për ta**, duke i vene këto pretendime fakti në kontekstin e ngjarjes kriminale të ndodhur më dt.24.06.2018, në qendër të të cilës, së paku nga deklarata e Policisë së Shtetit janë arrestuar shtetas, që nuk kanë asnjë lidhje me viktimin akuzuese Z.Taulant Balla. Në deklarimet e tij, i akuzuari Z.Lulzim Basha përdor në drejtim të viktimit akuzuese shprehje të tilla si "*garant i miliona eurove para të drogës të kapura në Toyota Yaris*", *ka porositur një "Toyota Yaris"...*"*Taulant Ballën i lidh trafiku i drogës, pastrimi i parave, ndërtimi i kullave, siç janë këto të Teatrit Kombëtar*"..."*bashkëpunimin me një nga bandat kryesore të drogës së Elbasanit, që i përkasin një prej bandave më të rrezikshme të trafikut të drogës*", shprehje te cilat nuk janë hipotetike, por janë akuza konkrete. Këtë pjesë të deklarimit të të akuzuarit, viktima akuzuese e konsideron si "*Shpifje*" të kryer botërisht ndaj tij, vepër penale e parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal.

Viktima akuzuese thekosn se, ndërkokë që kërkesa për të provuar të vërtetën e një gjykimi vlerësues (opinioni) është përgjithesisht e pamundur dhe shkel nenin 10 të KEDNJ (rrjedhimisht dhe nenet 22 e 23 të Kushtetutës), kërkesa për të provuar një standard të arsyeshëm prove për një deklarim faktesh, nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e mësipërme (*Lingens v. Austrisë, 08.07.1986* dhe *Mc Vicar v. Mbretërisë së Bashkuar nr.46311/99, GJEDNJ, v.2002*).

Viktima akuzuese Z.Taulant Balla pretendon se, në të tilla rrethana, i akuzuari Z.Lulzim Basha do të duhej të provonte në gjykim se pretendimet e tij "...*mbështeteshin në një bazë faktike mjaftueshmërisht të saktë dhe të besueshme, në përpjestim kjo me natyrën dhe shkallën e pretendimit...me kusht që sa më serioz të ishte pretendimi, aq me solide duhej të ishte baza faktike*" (*shih Pedersen and Baadsgaard v. Denmark, vendimi nr.49017 /99, dt 17.12.2004 i GJEDNJ*).

Viktima akuzuese pretendoi se, edhe pse në seancë gjyqësore Gjykata ka pyetur të akuzuarin Lulzim Basha, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, në lidhje se kush është personi apo "**burimi i besueshëm**" që ka vënë në dijeni të akuzuarin, përgjigja e përfaqësuesve të të akuzuarit, me autorizim dhe vendosmëri të këtij të fundit, ka qënë "*i vendosur të mos e bëj me dije gjykatën mbi burimin e informacionit!*"

Viktima akuzuese pretendon se, këto deklarime të të akuzuarit janë në kapërcim të "*lirisë së shprehjes*" e mbrojtur nga nen 10 i KEDNJ. Sipas viktimit akuzuese, nen 10/2 i Konventës lë pak hapësirë për kufizime ndaj fjalimeve politike apo për debate për çështje *«dë një interes publik»*. GJEDNJ është shprehur se : "...Për më tepër, kufijtë e kritikes së pranueshme janë më të

gjerë për një politikan sesa për një individ privat. Në ndryshim nga ky i fundit, i pari në mënyrë të paevitueshme dhe me dijeni bëhet objekt i një vëzhgimi të afërt të fjalëve dhe veprave dhe në vijim ai duhet të tregojë një shkallë më të madhe tolerance por megjithatë duhet vërejtur se teksa kufijtë e kritikës së pranueshme ndaj politikanëve janë më të gjerë, kjo nuk do të thotë se politikanëve nuk duhet tu jepet mundësia që të mbrojnë veten kur ata konsiderojnë se publikimet për ta janë të gabuara dhe të afta të çorientojnë opinionin publik..." (Sanocki v.Polonise, nr.28949/03, 17.07.2007 dhe Gasior v.Polonise Nr.34472/07, 21.02.2012.).

Në të njëjtën kohë neni 3 i Kushtetutës sanksionon ndër të tjera se "...djinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore janë bazat e këtij shteti, i cili ka per detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë".

Bazuar në këto dispozita, viktima akuzuese Z.Taulant Balla pretendon se, edhe deklaratat zyrtare politike nuk janë të pakufizuara. Këto deklarata nuk mund të janë të tilla, që të janë tërësisht të gabuara, të mbushura me shpifje me qëllim denigrimin e imazhit. Deklarata e bërë nga i akuzuari Z.Lulzim Basha ka patur një impakt shumë të madh, ajo është publikuar nga disa media të shkruara, gjithashtu është transmetuar nga shumë media vizive. Ka patur shikueshmëri e lexueshmëri të madhe si lajm rrjedhimisht dhe ndikimi në opinionin e gjerë publik, si edhe dëmet e shkaktuara në imazh për viktimen akuzuese Z.Taulant Balla kanë qënë mëdha.

Nisur nga këto deklarata, vihet re dukshëm **tendenca e të akuzuarit Z.Lulzim Basha për të sulmuar e démtuar imazhin e Z.Taulant Balla**, më qëllim démtimin e figurës së tij politike. I akuzuari Z.Lulzim Basha në ngritjen e kësaj akuze nuk ka paraqitur asnjë provë kundrejt viktimës akuzuese Z.Taulant Balla, edhe pse ka rezultuar se janë arrestuar të dyshuarit e kryerjes së kësaj vepre penale. Këtë deklaratë i akuzuari e ka bërë me qëllim démtimin e imazhit të viktimës akuzuese **Z.Taulant Balla** dhe përfitimin politik prej tij.

Nisur nga sa më sipër, viktima akuzuese Z.Taulant Balla pretendon se, i akuzuari Z.Lulzim Basha me anë të deklaratave dhëna prej tij më datat 21 dhe 25 qershor 2018, në sallën e Kuvendit të Shqipërisë si dhe përpara mediave, ka konsumuar plotësisht me dashje veprën penale të "Shpiffes" së kryer botërisht, të parashikuar nga neni 120/2 i KP, në dëm të viktimës akuzuese Z.Taulant Balla.

Kjo akuzë u kundërshtua nga i akuzuari Z.Lulzim Basha, nëpërmjet përfaqësuesve të tij. Edhe prokurori i çështjes mbajti të njëtin qëndrim, duke kërkuar pushimin e çështjes penale pasi, i akuzuari nuk provohet ta ketë kryer veprën penale por, ka qenë në ushrim të së lirisë së shprehjes dhe së drejtës së tij për informimin e publikut.

I akuzuari Z.Lulzim Basha pretendoi se, viktima akuzuese Z.Taulant Balla nuk provoi gjatë procesit gjyqësor ekzistencën e asnjë prej elementeve të veprës penale të parashikuar në nenin 120 të Kodit Penal. Sipas ligjit, që të ekzistojë vepra penale e "Shpiffes" duhet domosdoshmërisht, që të provohet përhapja e qëllimshme e një informacioni, **duke e ditur që është i rremë**. Thëniet e përhapura kundër viktimës akuzese jo vetëm duhet të janë të rreme, të jënë konkrete dhe diskredituese, poshtëruese, që cënojnë nderin e dinjitetin e tij, por ato duhet të dihen që janë të tilla.

Sipas të akuzuarit Z.Lulzim Basha, viktima akuzuese Z.Taulant Balla kishte **detyrimin sipas ligjit, që të provonte gjatë gjykimit, pikërisht ekzistencën e këtij elementi të anës subjektive të veprës penale**. Kjo përfaktin se nga ana subjektive, shpifja kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe më qëllim përfundimt poshtëruar e përfundimt diskredituar nderin dhe dinjitetin e personit tjetër. I akuzuarit nuk mund të jetë penalisht përgjegjës përfundimt veprën e shpifjes, nëse pohimet e nxjerra apo, të përhapura janë të vërteta, ose nëse ai ka pasur arsyet e bazuar përfundimt besuar në vërtetësinë e pohimeve të tilla.

Përfaqësuesit e të akuzuarit Z.Lulzim Basha pretendojnë, gjatë gjykimit u provua se, vetë viktima akuzuese ka pranuar ekzistencën e informacionit të siguruar nga Z.Basha dhe faktin se burimi i informacionit është i sigurt dhe serioz.

Konkretnisht, gjatë gjykimit u provua se vetë Z.Taulant Balla ka kallëzuar penalisht Z.Lulzim Basha përfundimt kryerjen nga ky i fundit të veprës penale të “Nxjerrjes së sekretit hetimor”. Në këtë kallëzim penal, të nenshkuar po nga viktima akuzuese Z.Taulant Balla dhe që u pranua prej tij edhe gjatë gjykimit si i vërtetë, pranohet dhe provohet se:

- 1- *Nëpërmjet fjalimit Kryetari i Partisë Demokratike Z.Lulzim Basha ka përhapur informacione që përbëjnë « sekret hetimor ».*
- 2- *Z.Lulzim Basha, me dashje të drejtëpërdrejtë ka përhapur informacione mbi akte, veprime sekrete;*
- 3- *I kallëzuari nuk ushtron detyrë publike të një natyre, nga e cila mund të vijë në dijeni te informacionit, që ai ka përhapur, por ky informacion PA ASNJË DISKUTIM I ËSHTË DHËNË NGA PERSONA QË KANË LIDHJE ME HETIMIN».*
- 4- *Ai (Lulzim Basha) ka bashkëpunuar me persona, të cilët janë në dijeni të një informacioni të tillë për shkak të detyrës».*

Nga ana tjetër – vijon pretendimin e tij i akuzuarit Z.Lulzim Basha – gjatë gjykimit u provuan edhe të dhënat e tjera, që shërbejnë si bazë e mjaftueshme faktike përfundimt besuar, që informacioni ishte i saktë dhe se i akuzuarit Z.Lulzim Basha nuk kishte asnjë arsyet përfundimt dyshuar vërtetësinë e informacionit. Nga këto pohime të viktimës akuzuese, të pranuara edhe gjatë procesit gjyqesor, rezulton e provuar se informacioni ekziston, dhe se ai, sipas viktimës akuzuese, është disponuar nga Z.Basha nga burime të besueshme. Përfundimt, nga pohimet e vetë viktimës akuzuese provohet se Z.Basha ka përdorur një informacion të besueshëm dhe që nuk ka patur asnjë arsyet e besonte që ky informacion ishte i rremë. **Është e pamundur që logjikisht të pranohet se jemi përparrë një shpifje, ndërsa përfundimt njëjtin fakt, të njëjtin person e akuzon se ka perhapur një informacion që përbën sekret hetimor.**

Përfaqësuesit e Z.Basha pretendojnë se, rezultoi e provuar se edhe pse Z.Basha nuk e përmendi me emër gjatë seancës së datës 21 Qershor 2018, Z.Taulant Balla e vetëpranoi se ishte personi që ju drejtua Z.Basha, dhe kete fakt e pranoi edhe publikisht, edhe në faqen 1 të kërkesës drejtuar Gjykatës.

Rezultoi e provuar gjithashtu se, me datë 24 Qershor 2018, në Portin e Durrësit ne orën 07:30 min, rmberriti një trajler tip “Bizark”, me 9 automjete, përmes Portit të Barit, Itali. Policia Kufitare ka bërë identifikimin dhe ndalimin e 2 mjetave tip “Toyota”, në të

cilat kanë gjetur një shumë të konsiderueshme eurosh dhe franga zviceriane, të padeklaruara.

Sipas të akuzuarit Z.Lulzim Basha pretendohet se, rezultoi e provuar gjithashtu, se deputeti Z.Taulant Balla, pranon lidhjen miqësore të ngushta me eksponentë të krimit të organizuar, siç është rasti i personit të dënuar me vendimin nr. 1735, datë 22.04.2008 të Gjykatës së Apelit Torino, Itali, me 21 vjet burg në Itali për pjesernarrje në krim të organizuar dhe trafikim të lëndëve narkotike, vendim gjyqesor që është njojur në organizuar dhe trafikim të lëndëve narkotike, vendim gjyqesor që është njojur në Republikën e Shqiperisë nëpermjet vendimit nr. 00-2010-1144, date 15.09.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Lidhur me këtë fakt **Gjykata konstaton se, kjo lidhje e pretenduar nuk kishte të bënte me objektin e gjykimit e për pasojë nuk mund të merrej në shqyrtim.**

I akuzuari Z.Lulzim Basha theksoi se, sipas vendimit nr. 7, dt.07.06.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në mënyrë që çdo ligj penal për shpifjen të mos cënojë lirinë e shprehjes, duhet të jetë në përputhje me këto dy kushte:

"(i) askush nuk duhet të dënohet për shpifje penale, nëqoftë se, pala që pretendon se ndaj saj është shpifur nuk vërteton, përtej dyshimeve të arsyeshme, praninë e të gjitha elementëve të kundërvajtjes, ... :

(ii) nuk duhet të flitet për vepër penale të shpifjes, nëqoftë se nuk vërtetohet se deklaratat cënuese janë të rreme, janë bërë me vetëdije që janë të rreme ose nga shkujdesja, për të vërtetuar nëse janë apo jo të rreme, dhe se janë bërë më qëllimin e veçantë për të dëmtuar palën që pretendon se ndaj saj është shpifur Provat për këtë fakt, duhet të jenë të padiskutueshme."

Në rastin konkret, sipas të akuzuarit Z.Lulzim Basha, gjatë procesit gjyqësor, rezultoi e provuar se nuk përbushet asnjë nga këto dy kushte. Sipas të akuzuarit rezulton se, viktima akuzuese nuk paraqiti asnjë provë, që provonte se, deklarimi i Z.Basha është i pavërtetë. Në procesin gjyqësor nuk u paraqit asnjë provë për të vërtetuar përtej dyshimeve të arsyeshme, praninë e të gjitha elementëve të veprës penale, përfshirë detyrimin për të provuar dijeninë e Z.Basha që informacioni ishte i rremë. Gjithashtu, është e provuar se nuk rezulton që ndonjë autoritet publik dhe kompetent sipas ligjit të ketë konstatuar se, këto deklarime janë të pavërteta. Vetë viktima akuzuese, në faqen 3 të kërkesës së tij pranon se deklarata e Z.Basha ka rezultuar e vërtetë, për shkak se në Portin e Durrësit më datë 24 Qershor 2018, janë ndaluar dy mjete tip "Toyota", brenda të cilave janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zviceriane, të padeklaruara.

I akuzuari pretendoi se, në kundërshtim me parimin e "*prezumimit të pafajësisë*", viktima akuzuese tentoi që të kalonte *barrën e provës* tek i akuzuarit. Sipas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të elaboruar edhe në vendimin nr. 7, dt.07.06.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, "*akuzë (çështje) kemi kur deklaratat e të akuzuarit janë të provuara katërcipërisht të pavërteta, konkrete dhe diskretituese, dhe jo kur ka dyshime se ato janë të pavërteta, sepse dyshimet shkojnë në favor të të akuzuarit. Barrën e provës në këto raste e ka kërkuesi (viktima akuzuese). Ai duhet të vërtetojë me prova pozitive, që deklaratat apo insinuatat që pretendohet se përbëjnë shpifje janë të rreme*".

Në rastin në shqyrtim, Taulant Balla nuk ka sjellë përpara kësaj gjykateasnje provë të vetme përvërtetësinë e pretendimeve të tij dhe pavërtetësinë e akuzave ndaj tij, dhe mbi të gjitha të djenisë nga ana e të akuzuarit përkëtë pavërtetësi në deklaratat e bëra prej tij, si elementë të domosdoshëm përkëtë vepër penale.

Jo pa qëllim legislatori i ka lënë barrën e provës palës që ngre padi për shpifje penale (kerkuesit), duke e kushtëzuar të vërtetojë gjithë elemenët e veprës, përtëj çdo dyshimi të arsyeshëm, pasi **vendosja e barrës së provës mbi të akuzuarin do të kishte efekt frenues mbi të drejtën e lirisë së shprehjes**.

I akuzuari Z.Lulzim Basha pretendoi se, gjatë procesit gjyqësor, të vetmet prova të paraqitura nga viktima akuzuese Z.Taulant Balla janë vetëm deklarimet e Z.Basha, të pasqyrura në media (*dy CD me keto pohime dhe pasqyrimin e tyre në shtypin e shkruar apo median elektronike*). Asnjë provë tjetër nuk është paraqitur gjatë këtij procesi. Viktima akuzuese nuk provoi përpara gjykatës as faktin që nuk është në ndjekje penale mbi faktet objekt informimi në fjalën e Z.Basha, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila po heton aferën e miliona eurove të padeklaruara, të kapura ne Portin e Durrësit. Vërtetimin nëse, një person është apo jo në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë, mund ta kerkojë sipas ligjit vetëm vetë personi.

Në kontekstin e analizës së deklaratave politike dhe informuese GJEDNJ ka mbajtur qartësisht qëndrimin se mbrojtja kryesore u jepet kërkessave të interesit të përgjithshëm të shoqërisë kundrejt kërkessave të individeve. Në vendimin për çështjen “*Jerusalem kundër Austrisë*”, GJEDNJ, në lidhje me nenin 10 te Konventës, nënvizon se: “*Në lidhje me çështjen nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vuri në dukje se kërkuesja ishte një politikane e zgjedhur dhe liria e shprehjes ishte veçanërisht e rëndësishme për një përfaqësuese publike të zgjedhur. Përkëtë arsy, do të duhesin argumente mjaft të fortë për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e kërkueses përlirinë e shprehjes*”.

Ndërkohë, GJEDNJ, në vendimin për çështjen “*Castells kundër Spanjës*”, shpjegoi se: “*liria e shprehjes është e rëndësishme përkëdo, por në veçanti për përfaqësuesin e zgjedhur të komunitetit. Është pikërisht ai që i përfaqëson zgjedhësit e tij, kthen vëmendjen ndaj shqetësimeve të tyre dhe mbron interesat e tyre*”.

Në këtë kontekst, përfaqësuesit e të akuzuarit Z.Lulzim Basha pretendojnë se, gjatë gjykimit u provua se deklarimet e Z.Basha nuk cënojnë rendin juridik. Deklarata e dhënë nga Z.Basha është pjesë e ushtrimit të së drejtës dhe detyrimit të tij përtë informuar publikun dhe në ushtrim të funksionit të tij përtë luftuar fenomentet negative në qeverisje dhe mbi të gjitha krimin. Nëpërmjet deklaratave të tij, Z.Basha ka synuar sensibilizimin e opinionit publik në lidhje me problematikën dhe nevojën për veprim nga organet e drejtësisë, dhe jo dëmtimin e imazhit shoqëror, diskreditimin apo cënimin e nderit të viktimës akuzuese, që nuk është asfare në fokus të punës së Kryetarit të opozitës.

Ky deklarim është bërë në kuadrin e lirisë së shprehjes nëpërmjet të cilët i është kërkuar organit të Prokurorisë të thellojë hetimet lidhur me faktin, çështje këto që kanë interes të lartë publik. Të informosh publikun përekzistencën e të dhënave konkrete, që përfshijnë një deputet të mazhorances në veprimtari të dyshuar kriminale apo mbështetjen e

grupeve kriminale, është pjesë e qënësishme e detyrave dhe përgjëgjesive të Kryetarit të opozitës dhe imponohet nga nevoja për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik. Pra, provohet se qëllimi i vërtetë i të akuzuarit ka qenë denoncimi dhe vënia në lëvizje e organit të Prokurorisë për hetime më të thelluara lidhur me çështjen. Kjo tregon se Z.Basha nuk ka pasur si qëllim që të disinformojë publikun dhe as të dëmtojë tërësinë e vlerave morale të viktimit akuzuese në opinionin shoqëror, por përkundrazi ka informuar këtë opinion, duke parashtruar përpara tij informacionet e veta lidhur me një fenomen apo çështje.

Përbën cënim të rëndë të lirisë së shprehjes tentativa e viktimit akuzuese për ta kaluar barrën e provës tek i akuzuari. Kjo është pa asnje dyshim tentativë e qartë për të penguar opozitën të permbush rolin e saj në një shoqëri demokratike, duke i kërkuar mbi të gjitha evidentimin prej saj të burimeve të veta të informacionit.

Në konkulzionin sa më sipër, i akuzuari Z.Lulzim Basha pretendon se gjatë gjykimit u provua se Z.Basha:

- Nuk ka përhapur qëllimi që esnjë informacion të rrremë.
- Nuk ka përhapur asnje informacion që është provuar ligjërisht që është i pavërtetë.
- Nuk ka patur asnje arsyе të bazuar për të besuar në pavërtetësinë e informacionit të marrë.
- Nuk ka perhapur me vetedije asnje informacion që ka dijeni që është i pavërtetë. Ka qenë në ushtrim të detyrimit të tij kushtetues si deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe në ushtrim të të drejtës së lirisë së shprehjes.

Ne konkluzion të sa më sipër, i akuzuari Z.Lulzim Basha pretendon se, viktima akuzuese Taulant Balla:

- nuk ka paraqitur asnje provë që verteton, përtej dyshimeve të arsyeshme, praninë e të gjitha elementeve të kundervajtjes penale, duke përfshirë që deklarata është e rrreme ose, që është bërë me vetedije qe është e rrreme, apo është bërë me qëllim të veçantë për të dëmtuar viktimen akuzuese.
- nuk arriti te provonte gjate gjykimit akuzat e ngritura prej tij.

Për këtë arsyë, nisur ka fakti që në deklaratat e Z.Lulzim Basha, nuk ekzistojnë elementë të veprës penale të "Shpifjes", pra fakti i pretenduar nuk ekziston, Gjykata, në mbështetje të K.Pr.Penale duhet të vendos deklarimin e pafajshmë të të akuzuarit dhe/ose pushimin e çështjes penale për shkak se fakti penal nuk provohet se ekziston.

Faktet e parashtruara më sipër provohen nga : dy DVD me pamje filmike të transmetuara nga televizonet Klan dhe A1 Report, të shoqëruara me shkresën përcjellëse të shoqërisë "Multiscreen" shpk dt.19.11.2018 dhe nr.4822/1prot, dt.12.12.2018 të Autorititë të Mediave Audiovizive; Deklaratë për shtyp e Policisë së Shtetit për ngjarjen e dt.24.06.2018; shkrime të publikuara në portaltet "hashtag.al"; "GazetaExpress", "shqiptarja.com"; "[bunkart.al](#)"; "[lapsi.al](#)"; "[mapo](#)"; "[gazetatema.net](#)"; "[apleNeës](#)"; dosja nr.,120 rregj, dt.27.06.2018 e Gjykatës së shkallës së parë për krimet të rënda ku është shkallur moskompetenca e saj për gjykimin e kërkuesës penale të viktimit akuzuese; etj... si dhe pohimet e palëve gjatë gjykimit.

Nisur nga pretendimet e parashtruara më sipër nga palët ndërgjyqëse Gjykata çmon se, ndodhemi përpara një konflikti ndërmjet lirisë së shprehjes dhe të drejtës për të përcuar informacion nga i akuzuari Z.Lulzim Basha njëra anë dhe nga ana tjetër, atë të së drejtës së mbrojtjes se reputacionit, nderit dhe dinjitetit të viktimës akuzuese Z.Taulant Balla.

Për pasojë, Gjykata vëren se, për zgjidhjen e kësaj çështjeje do t'iu referohet dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut (më poshtë KEDNJ), jurisprudencës vendase të Gjykatës së Lartë (më poshtë GJL) dhe asaj të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut (më poshtë GJEDNNJ), si dhe Kodit Penal të RSH. Konkretisht :

- a) Nenit 22 të Kushtetutës, i cili parashikon se : “*Liria e shprehjes është e garantuar.*”
- b) Nenit 23 të Kushtetutës, i cili parashikon se : “*E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore....*”
- c) nenit 8 të KEDNJ “**E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare**”, i cili parashikon se : “*1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.*”
- d) nenit 10 të KEDNJ “**Liria e shprehjes**”, i cili parashikon se : ““*1. Çdokush ka te drejtën e lirisë se shprehjes.Kjo e drejte përfshin lirinë e mendimit dhe liritë për të marrë ose për te dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteteve publike dhe pa marre parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet qe te kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve te transmetimit kinematografike ose televizive. 2.Ushtrimi i këtyre lirive qe përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund tu nënshtrohet atyre formaliteteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksione te parashikuara me ligj dhe qe janë te nevojshme në një shoqëri demokratike,ne interes te sigurisë kombëtare,integritetit territorial ose sigurisë publike,për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit,për mbrojtjen e shëndetit ose te moralit,për mbrojtjen e dinjitetit ose tësë drejtave tëtëtjerëve,për të ndaluar përhapjen e te dhënave konfidenciale ose per te garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor*”.
- e) nenit 73 të Kushtetutës , i cili parashikon se : “*Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.2...*”
- f) nenit 17 të Kushtetutës së RSH, i cili parashikon se : “*Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Kufizimi*

duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

- g) nenit 120 të Kodit Penal të RSH “**Shpifja**” , i cili parashikon se : “*Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjeter, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetëmijë gjer në një milion e pesëqindmijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetëmijë gjer në tre milionë lekë.*”

Nga përbajtja dhe interpretimi i dispozitave të mësipërme, parimisht nxjerrim konkluzionin se : “*...liria e shprehjes dhe e informimit është e garantuar dhe e mbrojtur nga ligji për këdo, por kjo liri mund t'u nënshtrohet kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj në rastet kur (veç të tjerash) prek moralin, nderin, dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Parashikimi në Kodin Penal i veprave penale të fyteres dhe shpiffes dhe sanksionet që ato përbajnë, janë pikërisht masat që me ligj janë marrë për mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit të personit.*”¹ Cëndimi i këtyre marrëdhënieve passjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar nga ligji si vepër penale duhet që :

- ❖ objekt i veprës penale të jetë ndjenja e nderit dhe dinjitetit të personit, emri i mirë apo reputacioni i personit fizik a juridik, në kuadër të vlerësimit që ai gëzon në opinionin shoqëror.
- ❖ Sipas nenit 120 të KP, nga ana objektive i pandehuri me veprime aktive, të kundraligjshme përhap me gojë, duke biseduar me persona të tjerë, me shkrim, etj..., fakte të pavërteta dhe të rreme për personin e dëmtuar. Në këtë kuptim autori i veprës penale duhet që :
 - a) të përhapë thënie apo, çdo informacion tjeter, me shkrim, me gojë apo në çfarëdo mënyrë tjeter ;
 - b) thëni apo informacioni të jenë të rremë, çka nënkupton se jo vetëm objektivisht ky informacion duhet të jetë i rremë, por se edhe subjektivisht, personi që i përhap ato ta dijë se janë të rreme. Ky element e dallon këtë vepër nga “fyterja”, për të cilën nuk nevojitet që informacioni të jetë domosdoshmërisht i rremë, ai mund të jetë dhe real, por diskretitues, mjafton që të cenojë ndjenjën e dinjitetit të personit;
 - c) thëni apo informacioni të jenë konkretë ;
 - d) thëni apo informacioni të jenë diskretituese, me qëllim cënimin e nderit dhe dinjitetit të personit, të cilët i adresohen.
 - e) Nëse këto veprime bëhen botërisht apo, në dëm të disa personave apo, më shumë se një herë, vepra do të cilësohet sipas pg.II të nenit 120 të KP.

¹ shih vendimin nr.8, dt.05.06.2015 i Kolegit Penal të Gjykatës së Lartë të RSH.

- ❖ subjekti i veprës penale të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur 16 vjeç.
- ❖ Nga ana subjektive, kjo kundërvajtje penale kryhet me dashje direkte. Element cilësues, pa të cilin kjo vepër nuk mund të ekzistojë është qëllimi – dashja e dretëpërdrejtë për të poshtëruar e diskretituar nderin dhe dinjitetin e personit, me qëllim që opinioni shoqëror të ndryshojë në mënyrë pexhorative, vlerësimin që ka për këtë të fundit.

Sa i përket barrës së provës, Gjykata vlerëson se, pala akuzuese (viktima) e konsideruar si subjekt i procedimit penal, në vështrim të ligjit procedural penal - neneve 59 e 60 të K.Pr.Penale, ka barrën e të provuarit të akuzës për gjykimet e iniciuara nga ana e saj. Parë në këtë këndvështrim, ligji procedural penal e ngarkon këtë palë me detyrimin për të paraqitur prova, të cilat vërtetojnë akuzën e pretenduar prej kësaj pale. Ndërsa Prokurori në gjykime të kësaj natyre, është pjesëmarrës gjatë debatit gjyqësor dhe sipas rastit, kërkon dënimin e të akuzuarit ose pafajësinë e tij.

Kjo do të thotë se, në procesin gjyqësor penal, që fillon me kërkeshë të viktimës akuzuese, barra e provës bie mbi viktimën akuzuese, e cila ka njëherazi detyrimin të vërtetojë gjithë elementët e veprës, përtëj çdo dyshimi të arsyeshëm².

Bazuar në dispozitat kushtetuese, ato të KEDNJ si dhe jurisprudencës vendase dhe asaj të GJEDNJ, Gjykata thekson se, liria e shprehjes është një e drejtë thelbësore e garantuar nga legjislacioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e të tretëve, apo autoriteteve publike, duke respektuar kufijtë ligjor.

Liria e shprehjes, së bashku me **“të drejtën e informimit**, si liri dhe të drejta themelore në një shoqëri demokratike janë një parakusht për të gëzuar liritë dhe të drejtat e tjera dhe garantohen nga nenet 22 e 23 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Liria e shprehjes garantonhet edhe nga neni 10 i KEDNJ me titull “*Liria e shprehjes*”. Për më tepër GJEDNJ i ka zgjeruar shumë kufijtë e lirisë së shprehjes. Kjo Gjykatë thekson se kjo e drejtë përfshin lirinë e zotërimit të bindjeve, si dhe të marrjes apo transmetimit të informacioneve dhe të ideve pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht kufijve shtetërorë.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka zbërthyer raportin ndërmjet lirisë së shprehjes së individit, lirisë së shtypit, radios dhe televizionit, si dhe të drejtës së informimit, referimi tek të cilat i shërbën gjykatës për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi. GJEDNJ i jep më tepër rëndësi disa elementëve si:

- ❖ *Pozicioni i kërkuesit dhe personit të fyter;*
- ❖ *Natyra dhe objekti i deklaratave të pretenduara poshtëruese;*
- ❖ **Kualifikimi/cilësimi i tyre si deklarata fakti apo opinione;**
- ❖ *Fjalët e përdorura;*
- ❖ *Ekzistenca e provave për vërtetësinë e deklaratave të pretenduara fyeze.*

² shih Vendimet nr.3/2008 dhe 39/2000 të Gjykatës Kushtetuese të RSH.

deklaruar se : “Fushëveprimi për kufizimet ndaj fjalimeve a debateve politike lidhur me çështjet e interesit publik është i vogël”.³ Kjo lidhet ngushtë me qëndrimin e GJEDNJ për rëndësinë e lirisë së shprehjes si një shtyllë e demokracisë.

Në një çështje tjetër GJEDNJ është shprehur se : “Kufijtë e kritikës së pranueshme janë...më të mëdha kur kemi të bëjmë me politikanë sesa kur kemi të bëjmë me individë private. Në dallim nga këta të fundit, të parët në mënyrë të paevitueshme dhe me vetëdije e vendosin veten në një kontroll më të madh për çdo fjalë dhe vepër të tyre,...rrjedhimisht duhet të tregojnë një shkallë më të madhe të tolerancës.”⁴

Në rastin konkret, bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjkata konstaton se u provua që, viktima akuzuese Z.Taulant Balla është deputet i Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë. I akuzuari Z.Lulzim Basha është kryetar i Partisë Demokratike, njëkohësisht edhe deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

Në fjalimin e tij në Kuvend të datës **21 qershor 2018**, i akuzuari Z.Lulzim Basha ka diskutuar rrëth çështjes së hapjes së negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Nga foltorja e Kuvendit, ai diskutoi për shqetësimin e Gjermanisë, skeptike sipas tij, për t'i dhënë “ok” hapjes së negociatave me Shqipërinë. Gjithashtu, Z.Basha është shprehur se opozita ka ndikuar pozitivisht në lidhje me këto negociata, fjali kjo që ka shkaktuar të qeshura në parlament.

Në këtë moment i akuzuari Z.Lulzim Basha i është drejtuar deputetit Z.Taulant Balla me fjalët “Njëri prej atyre që zgërdhijet më shumë ka qënë në Gjermani para 3 ditësh, ka porositur një “Toyota Yaris”. Po ta kanë zbuluar Toyotën o zgërdhimit bashkë me 1.5 milion euro të drogës brenda, vazhdo qesh se do të shikosh se çfarë do të të tundet përpara hundës shumë shpejt...”

Ky fjalim i tij, përvçse është transmetuar drejtëpërdrejtë nga seanca e Kuvendit, është transmetuar gjithashtu disa herë nga mediat. Gjithashtu, është bërë lajm nga mediat e shkruara dhe portalet në internet dhe ka patur një përhapje të gjërë.

Gjkata vëren se, ka rezultuar i vërtetë fakti se më datë **24 qershor 2018**, në Portin e Durrësit në orën 07:30, mbërriti nga Belgjika një trajler tip “Bizark” me 9 automjete, përmes Portit të Barit, Itali. Policia Kufitare ka bërë identifikimin dhe ndalimin e 2 mjeteve tip “Toyota”, në të cilat janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zviceriane, të padeklaruara.

Lidhur me këtë fakt Policia e Shtetit më pas në një deklaratë për shtyp (*shih fq.14 e dosjes së Gjkatës së shkallës së parë për krime të rënda Tiranë*) ka informuar se : “Policia e Shtetit është vënë në dijeni nga burimet e saj vëndase, në datë 20 Qershor 2018, ditën e mërkurë, për një karoatrec që pritej të transportonte disa autovetura, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruara, pa specifikuar tipin e automjeteve dhe as origjinën e vendit. Me marrjen e këtij informacioni, i'u është dhënë porosi gjithë strukturave në Pikat e Kalimit Kufitar për konstatimin dhe kontrollin e kësaj ngarkese.”

Ditën e enje, 21 Qershor 2018, në mesditë, gjatë punimeve në sallën e Kuvendit, është bërë publik fakti lidhur me një automjet tip “Toyota Yaris” me 1,5 milion euro, të zbuluar në

³ shih psh: Dichand dhe të tjera kundër Austrisë, v.2002, pg.38.

⁴ shih Lingens kundër Austrisë, v.1986, pg.42.

Gjermani. Po atë ditë, të enjten e kaluar, datë 21 Qershor 2018, një agjenci ligjzbatuese shqiptare në orën 17:00, ka njoftuar Policinë e Shtetit lidhur me një informacion për një ngarkesë me trajler që do të sillte disa mjete tip "Toyota", e cila pritej të vinte nga Gjermania, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruara. Policia ka arrestuar në flagrance shtetasit:

A.Ç., 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës;

E.L., 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë;

K.L., 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë;

A.M., 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë.

Gjithashtu janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasve:

A. V., 33 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë;

E. V., 38 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë.

Gjatë gjykimit Gjykata çnon se, u provua se, deklarata e të akuzuarit Z.Lulzim Basha ka rezultuar të jetë pjesërisht e vërtetë, pasi janë ndaluar automjete të tilla tip "Toyota", por është totalisht i pavërtetë fakti se kjo/këto makinë/a ka ardhur me porosi të Z.Taulant Balla. Ka rezultuar i vërtetë fakti se kanë ardhur në port dhe kanë ndaluar dy mjete tip "Toyota", por nuk lidhen aspak me deputetin Z.Taulant Balla (sihi deklaratën zyrtare të Policisë së Shtetit).

Gjatë këtij gjykimi nuk u paraqit asnjë provë apo dëshmi që të lidhë deputetin Z.Taulant Balla me makinat e ndaluara, si edhe sasinë e parave të gjendura në to.

Në deklarimet e tij të mëvonëshme i akuzuari Z.Lulzim Basha përdor në drejtim të viktimës akuzuese Z.Taulant Balla shprehje të tillë si "garant i miliona eurove para të drogës të kapura në "Toyota Yaris", ka porositur një "Toyota Yaris"..." "Taulant Ballën i lidh trafiku i drogës, pastrimi i parave, ndërtimi i kullave, siç janë këto të Teatrit Kombëtar"..." bashkëpunimin me një nga bandat kryesore të drogës së Elbasanit, që i përkasin një prej bandave më të rrezikshme të trafikut të drogës".

Referuar edhe interpretimeve dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë të RSH dhe asaj të GJEDNJ, Gjykata vlerëson se, deklarimet e të akuzuarit Z.Lulzim Basha të bëra prej tij më datat 21 qershor 2018 dhe 25 qershor 2018 nuk luajnë një rol informues, pasi ato nuk rezultojnë të vërteta. Me këto deklarata, të bëra botërisht, në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, përparrë një numri të madh personash e të transmetuar më pas nga Media vizive, elektronike dhe ajo e shkruar (TV Klan, A1 Report, lapsi.al, hashtag.al, gazetatema.net, shqiptarja.com, etj...) i akuzuari Z.Lulzim Basha ka dashur me qëllim, t'i përçojë publikut mesazhin se, viktima akuzuese Z.Taulant Balla, njëherazi deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe ekspONENT i lartë i Partisë Socialiste të Shqipërisë, është një bashkëpunëtor i krimit të organizuar, pasi bashkëpunon me persona të përfshirë të krimës së tillë si trafik lëndësh narkotike, apo pastrim parash, del garant për këta persona, u siguron mbrojtje nga shteti, etj...

Gjykata arrin në përfundimin se, deklarimet e përmendura më lart, përbëjnë një pretendim fakti, i cili në vetvete, në mënyrën si është formuluar, përbën një akuzë tejet serioze. Akuza është konkrete pasi, i akuzuari Z.Lulzim Basha deklaron se, viktima akuzues Z.Taulant Balla bashkëpunon me njerëz me precedentë penalë/pjestarë të krimit të

organizuar, kujdeset për ta, shkëmben me ta favore, duke i vënë këto pretendime fakti në kontekstin e ngjarjes kriminale të ndodhur në dt.24.06.2018 në Portin e Durrësit, ku janë kapur automjetet “Toyota”, brenda të cilave u gjet një shumë e konsiderueshme kartëmonedhash euro dhe franga zviceriane të padeklaruara.

Por, sikundër rezultoi gjatë gjykimit, deri më sot nuk ka asnjë provë që të vërtetojë përfshirjen e viktimës akuzuese Z.Taulant Balla në këtë ngjarje kriminale por, janë marrë si të dyshuar persona, të cilët nuk ka asnjë lidhje me viktimin akuzuese.

Gjkata arrin në përfundimin se, në deklarimet e tij, i akuzuari Z.Lulzim Basha përdor në drejtë të dëmtuarit akuzues Z.Taulant Balla shprehje, të cilat nuk janë hipotetike dhe nuk lenë të hapur asnjë mundësi për publikun, që të hamendëson apo të krijonte vetë dyshimin e bindjen për faktin e pretenduar dhe të bënte vlerësimin e tij.

Ndërkohe që, kërkesa për të provuar të vërtetën e një gjykimi vlerësues (opinioni) është përgjithësish e pamundur dhe shkel nenin 10 te Konventës (rrjedhimisht dhe nenet 22 e 23 të Kushtetutës), kërkesa për te provuar një standard të arsyeshëm prove për një deklarim faktesh, nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e mësipërme. (Lingens kundër Austrisë, 08.07.1986 dhe McVicar kundër Mbretërisë së Bashkuar nr.46311/99,G.J.E.D.NJ,2002)⁵.

Në të tilla rrethana, i akuzuari Z.Lulzim Basha do të duhej të provonte në gjykim se pretendimet e tij “.. mbështeteshin në një bazë faktike mjaftueshmërisht të saktë dhe të besueshme,në përpjestim kjo me natyrën dhe shkallën e pretendimit....me kusht që sa më serioz të ishte pretendimi, aq më solide duhej të ishte baza faktike” (Pedersen and Baadsgaard v.Denmark,vendimi nr.49017/99, dt 17.12.2004 i Gj.E.D.Nj). Një qëndrim të tillë ka mbajtur jurisprudanca shqiptare në një rast të ngjashëm.⁶

Ndërkohe që, provat e paraqitura në gjykim nga i akuzuari Z.Lulzim Basha nuk krijojnë asnjë bazë besueshmërie në lidhje me saktësinë apo vërtetësinë e pretendimeve të tij faktike, konkretisht të njohjes së të dëmtuarit akuzues Z.Taulant Balla me shtetasit e arrestuar e të përmendor në deklaratën e Policisë së Shtetit, lidhur me ngjarjen kriminale të ndodhur më dt.24.06.2018 në Portin e Durrësit, apo për përkatësinë e parave të kapura; bashkëpunimin e viktimës akuzuese me këta persona apo të tjerë (banda e Elbasanit) për trafikimin e lëndëve narkotike apo pastrimin e parave; apo ndihmën që viktima akuzuese u jep këtyre personave.

Madje, mbrojtësit e autorizuar prej tij, i bënë me dije Gjykatës se, kishin marrë porosi nga i akuzuari Z.Lulzim Basha, që në asnjë moment të mos tregonin burimin e informacionit të tij, edhe pse nuk është një ndër subjektet proceduriale, të cilit Kodi i Procedurës Penal i garanton të drejtën për të mos treguar burimin e informacionit.

Për pasojë Gjkata çmon se, Z.Lulzim Basha hoqi dorë nga e drejta për të provuar përpara Gjykatës se, informacioni me natyrë fyeze kundrejt Z.Balla, që Z.Basha kishte përcjellë në këto deklarata, kishte një bazë mjaftueshmërisht të saktë dhe të besueshme. Rrjedhimisht, veprimi i të akuzuarit në këtë rast, nuk është në

⁵ Shih për ngjashmëri vendimin nr.8, dt.05.06.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të RSH.

⁶ Shih për ngjashmëri vendimin nr.8, dt.05.06.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të RSH.

përputhje me kushtet e elaboruara nga vendimi nr.7, dt.07.06.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pasi arsyetimi në këtë vendim nuk i garanton mosndëshkim nga neni 120 i KP, dikujt që heq dorë me vullnet të lirë nga paraqitja e mbrojtjes së tij, në rastin kur pala kundërshtare paraqet prova, që janë të sakta dhe të besueshme. Këtë qëndrim ka mbajtur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në një rast të ngjashëm.⁷

Gjykata çmon se, përhapja e këtyre deklarimeve nga ana e të akuzuarit Z.Lulzim Basha, përderisa nuk ka qëllim informues, është shpërdorim i lirisë së shprehjes që mbrohet nga nenet 22, 23 e 73 të Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ, si dhe janë bërë me qëllim për të denigruar e njollosur nderin, reputacionin dhe vlerësimin që ka opinioni shoqëror publik vendas e i huaj për viktimin akuzuese Z.Taulant Balla.

I akuzuari Z.Lulzim Basha, është madhor, mbi 16 vjeç, me zotësi të plotë për të vepruar dhe Kreu i Partisë Demokratike Shqipërisë. Për pasojë, ai ka të gjithë aftësinë dhe kapacitetin intelektual, politik e profesional për të kuptuar :

- a) peshën e deklarimeve të tij faktike (dhe jo opinion-bërëse),
- b) nevojën për t'i mbështetur ato në prova ose të dhëna mjaftueshmërisht të sakta e të besueshme. Sikundër u vërtetua gjatë gjykimit, i akuzuarit Z.Lulzim Basha nuk arriti të provonte bazën faktike mjaftueshmërisht të saktë dhe të besueshme të deklaratave të tij të dhëna më dt.21 qershor dhe më dt.25 qershor 2018 në sallën e Kuvendit dhe në media.

Deklarata e policisë e bërë ditën e ngjarjes vërteton pretendimin e viktimës akuzuese se, ai nuk ka asnjë lidhje me ngjarjen kriminale të ndodhur më dt.24.06.2018 në Portin e Durrësit dhe të referuar nga policia. Gjithashtu, sikurse u pohua edhe nga përfaqësuesit e të akuzuarit hetimi i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar ende e për pasojë, nuk kemi asnjë vendim të formës së prerë, që të ketë shpallur fajtor të akuzuarit e aq më pak të ketë përfshirë apo deklaruar fajtor viktimë akuzuese Z.Taulat Balla për këtë ngjarje kriminale. Në këtë kuptim do të prevalojë parimi i “*prezumimit të pafajësisë*” ndaj të gjithë personave të përfshirë në këtë ngjarje kriminale, derisa të kemi një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Gjykata konstaton se, Z.Taulant Balla ka depozituar kallëzim ndaj Z.Lulzim Basha, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Përhapjes së sekretit hetimor*”. Por ky kallëzim – në të kundërt të asaj që pretendon i akuzuarit – nuk do të thotë se, Z.Taulant Balla ka pohuar se, informacioni kundër tij ishte i vërtetë. Pranimi i të kundërtës do të ishte alogjike. Nëse lexohet përbajtja e kallëzimit konstatohet se, thelbi i kallëzimit ka qenë përhapja e informacionit për një automjet “*Toyota*”, brenda së cilit ishin fshehur sasira të konsiderueshme kartëmonedhash të huaja dhe se, përhapja e këtij informacioni disa ditë përpëra se, më dt.24.06.2018 të finalizohej operacioni i Policisë shqiptare në portin e Durrësit, konsiderohet nga Z.Balla përhapje e sekretit hetimor, duke e dëmtuar rëndë këtë proces penal.

⁷ shih vendimin nr.8, dt.05.06.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të RSH.

- c) përgjegjësinë që mund të mbante në rast të kundërt.
- d) cënimin që i bën nderit dhe dinjitetit te të dëmtuarit akuzues nëpërmjet deklaratave të tilla.

Sa më sipër Gjykata arrin në përfundimin se, deklaratat e bëra botërisht të akuzuarit Z.Lulzim Basha kanë qartësisht natyrë shpifëse ndaj viktimit Z.Taulant Balla. Për pasojë, Gjykata çmon se, me veprimet e mësipërme i akuzuari Lulzim Basha ka konsumuar plotësisht elementët e kundërvajtjes penale të "Shpiffes" së kryer botërisht, parashikuar nga nen 120/2 i KP, në dëm të viktimit akuzuese Z.Taulant Balla. Rrjedhimisht, Z.Lulzim Basha duhet të deklarohet fajtor për këtë vepër penale.

Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit Gjykata çmon se, duhen mbajtur parasysh këto rrethana :

1. Rrezikshmërinë relativisht të ulët të veprës penale të parashikuar nga nen 120/2 i KP, për të cilat ligjvënesi ka parashikuar një dënim vetëm me gjobë.
2. Faktin se, kjo vepër penale ka marrë përhapje të gjerë, duke u bërë një shqetësim serioz për politikanë, përfaqësues të shtetit, nëpunës shtëtëror e publikë dhe individë të thjeshtë, çka rrjet rrezikshmërinë shoqërore të saj.
3. Faktin se, si viktima akuzuese ashtu edhe i akuzuari janë persona me rëndësi dhe ndikim të madh në jetën shoqërore dhe politike të vendit. Për pasojë, edhe impakti i sjelljeve dhe veprimeve të tyre në shoqëri është i lartë. Për shkak të rolit që kanë zgjedhur të luajnë në jetën publike, sjellja dhe veprimet e tyre duhet të reflektojnë nivelet më të larta të etikës qytetare, pasi ata konsiderohen se, duhet të janë shembull për publikun e gjerë. Në këtë kontekst, edhe rëndësia e lirive dhe të drejtave që iu shkelen apo shkelin është e lartë dhe kërkon një mbrojtje të përshtatshme.
4. Faktin se, i akuzuari nuk e pranon akuzën.
5. Faktin se, i akuzuari është i padënuar, kryefamiljar, me fëmijë dhe burim kryesor i të ardhurave në familjen e tij.

Në këto kushte Gjykata, në vështrim të neneve 47-50 të K.Penal çmon se, i akuzuari Z.Lulzim Basha duhet të dënohet me 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë gjobë. Nisur nga kushtet social-ekonomike të të akuzuarit dhe vlera e gjobës, në aplikim të nenit 34 të KP Gjykata çmon se, i akuzuari Lulzim Basha duhet ta shlyejë këtë gjobë në favor të shtetit brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh, nga dita që ky vendim do të marrë formë të prerë.

Në përfundim të këtij arsyetimi Gjykata çmon se, ky dënim do të shërbejë edukimit të të akuzuarit, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i akuzuari, rehabilitimit të tij, si dhe parandalimit të përgjithëshëm të kësaj vepre penale në shoqëri.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 58, 59, 379, 384, 390 e 485 të K.Pr.Penale,
VENDOSI

1. Deklarimin fajtor të të akuzuarit Z.Lulzim Basha, për kryerjen e veprës penale të "Shpiffes", së kryer botërisht në dëm të viktimit akuzuese Z.Taulant Balla, parashikuar

nga nenit 120/2 i K.Penal dhe në bazë të këtij nenit, dënimin e të akuzuarit **me 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë gjobë.**

2. Në aplikim të nenit 34 të KP, i akuzuari Z.Lulzim Basha do ta paguajë këtë gjobë brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh, nga dita që ky vendim do të marrë formë të prerë.
3. Shpenzimet proceduriale në ngarkim të të akuzuarit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot më dt.21 janar 2019!

SEKRETARE

Silvi XHAKOLLI

GJYQTAR

GERD HOXHA